





SISTEMI CLINGO

QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE BIOMJEKËSORE
MANUAL PËRDORIMI

Kjo faqe është lënë qëllimisht e bardhë



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE BIOMJEKËSORE
MANUAL PËRDORIMI : SISTEMI CLINGO



- Nivel Përdoruesi –



<https://new.shendetesia.gov.al/>



<http://www.biomedical.gov.al/>

2020

Përmbajtja

Sugjerime	5
A. Njihuni me Clingo-n	6
B. Aksesimi i platformës.....	6
B.1) Lidhjet në internet	6
B.2) Aksesimi i llogarisë.....	11
B.3) Menutë.....	12
C. Inventari dhe testet e pranimi	14
C.1) Inventari	18
C.2) Pajisje/Prodhuës/Model	24
C.3) Dallimi njësi qendrore / modul	26
C.4) Të dhëna të tjera.....	29
D. Nxjerrja e pajisjes jashtë funksioni.....	29
E. Politikat dhe privatësia	32
F. Asistenca dhe suport	33
F.1 Error-et.....	33
F.2 Pyetje / Përgjigje	34
G. Shtesë / Shënime	35

Sugjerime

Këshillohet leximi i këtij manuali nëpërmjet referimit në kohë reale bazuar në sistemin aktiv Clingo, të aksesuar në shfletuesin, pajisjen tuaj.

Sugjerohet gjithashtu realizimi i provave, testimeve të vazhdueshme në lidhje me funksionalitetet aktuale në sistemin përkatës, drejt përmirësimit të aksesueshmërisë dhe aplikimit të sistemit përkatës.

Sugjerohet kontrolli i vazhdueshëm në lidhje me të dhënat, veprimtarinë e përdoruesit aktual bazuar në llogarinë përkatëse drejt përmirësimit apo përditësimit të të dhënave dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre.

Këshillohet leximi i plotë i këtij manuali. Për çdo problem apo informacion mund të referoheni në seksionin e asistencës dhe suportit në po këtë manual përdorimi.



A. Njihuni me Clingo-n

Pajisjet mjekësore konsiderohen si aset më i rëndësishëm bazuar në terrenin apo infrastrukturën e institucioneve shëndetësore. Referuar rolit dhe rëndësisë që aparaturat paraqesin në qendrat shëndetësore, është e rëndësishme identifikimi dhe manaxhimi i tyre për një mirëmbajtje efikase dhe afatgjatë.

Sistemi ‘Clingo’ është programuar për të manaxhuar mirëmbajtjen, ecurinë e asetit mjekësor bazuar në të dhënat përkatëse duke ofruar ndërfaqe ‘user friendly’ bazuar në funksionalitetet aktuale. Konsiderohet i lehtë në përdorim, i sigurtë dhe garanton performancë. Më poshtë paraqiten hapat për të aksesuar sistemin në fjalë. Gjuha bazë e sistemit është shqip.

B. Aksesimi i platformës

Sistemi ‘Clingo’ aksesohet gjerësisht në internet nëpërmjet rrjetit aktual në të cilën ndodheni duke garantuar akses ndaj tij kudo. Për këtë është e nevojshme të përdorni shfletuesit e internetit si Opera, Firefox, Internet Explorer, Google Chrome etj. **Sugjerohet të përdoret browser-i Google Chrome** pavarësisht sistemeve të operimit (Windows / Linux) apo tipeve të pajisjeve (Desktop / Laptop / Smartphone / Tablet). Programi Clingo nuk kërkon burime të konsiderueshme kompjuterike, por mund të aksesohet gjithashtu bazuar edhe në kapacitete minimale nëpërmjet një lidhjeje të mirë në internet.

B.1) Lidhjet në internet

Sistemi Clingo mirëmbahet dhe manaxhohet nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKTB). Sistemi i manaxhimit nuk paraqitet nëpërmjet kërkimeve në internet, për këtë është e nevojshme të ndiqen procedurat si më poshtë vijon:

1) Aksesoni website-n ‘QKTB’

Nëpërmjet kërkimeve bazuar në ‘Qendrën Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKTB)’ në internet do të mund të aksesoni website-n aktual të institucionit bazuar në listimet/rezultatet përkatëse të kërkimit. Imazhi ilustron si më poshtë:




Fig.1: Rezultatet bazuar në kërkimet ndaj ‘QKTB-së’

Duke klikuar në rezultatin e parë të listuar do të mund të aksesoni website-n siç paraqitet në imazhin më poshtë.



Mirësevini në faqen e QKTB!


Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore, është një institucion nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka si qëllim të saj mbështetjen e gjithë strukturave të sistemit shëndetësor publik për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, si dhe ofrimin e një niveli të lartë kompetence në fushën e Inxhinierisë Klinike. Në këtë kuadër, objektivi ynë kryesor është ofrimi i një shërbimi të standardeve më të mira ndërkombëtare të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë mjekësore në përputhje edhe me rekomandimet dhe direktivat e KE, për të mundësuar që jo vetëm pajisjet të jetojnë gjatë në kushte pune, por të garantojë siguri për pacientët, përdoruesit dhe të tjerët.

Fig.2: Website i institucionit (2019)

Website-n aktual të institucionit do të mund ta aksesoni edhe në mënyrë direkte nëpërmjet URL: <http://www.biomedical.gov.al/> .

2) Aksesoni sistemin ‘Clingo’

Pozicionohuni në seksionin përkatës të programit Clingo në website-n që sapo aksesuat. Imazhi më poshtë paraqet edhe butonin drejt aksesimit të platformës.



Duke klikuar 'Aksesoj', sistemi Clingo do të paraqitet në një tab të ri. Imazhi më poshtë paraqet rezultatin përkatës.

Sistemi mund të aksesohet gjithashtu direkt nëpërmjet URL:

<http://134.0.34.26/Clingoengine/login.asp?CUSTOMERID=ALBANIA&>

Fig.3: Seksioni Clingo (2019)




Fig.4: Sisitemi Clingo (faqja e parë)

3) Extension

Sugjerohet aplikimi dhe përdorimi i extension-it 'IE tab' drejt aksesit të plotë të ndërfaqes së aplikacionit web. Ndaj është e nevojshme instalimi i elementit përkatës. Imazhi më poshtë paraqet rezultatet e kërkimit në lidhje me 'IE tab extension'. Më pas ndiqni vijimësinë e instalimit deri në përfundimin e saj.




Fig.5: IE tab Extension




Fig.6: IE tab Extension – Instaluar

Pasi të keni instaluar me sukses elementin e paraqitur më sipër, sigurohuni që ta keni listuar në krye të listës së 'extension-ave' krahas të tjerëve alternativë. Extensioni i sapo vendosur do të paraqitet automatikisht krahas 'url bar-it' në të djathtë. Nëse extension-i i ri mungon krahas 'url bar-it', paraqiteni atë duke e aktivizuar si në imazhin e mëposhtëm (settings->more tools->extensions).




Fig.7: Paraqitja e 'IE tab Extension'

Pasi të keni paraqitur funksionalitetin e extension-it krahas 'url bar-it', si dhe të keni aksesuar dhe paraqitur sistemin Clingo në tab-in aktual, klikoheni atë. Sigurohuni që të paraqitet 'bar-i' i fokusuar në imazhin e mëposhtëm.




Fig.8: Aplikimi i 'IE tab Extension'

4) Konfigurimi i 'IE tab Extension'

Extension-i i sapovendosur mund të konfigurohet duke klikuar në ikonën përkatëse. Ndodh që edhe pas aplikimit të extension-it në fjalë bazuar në sistemin Clingo, ndërfaqja e aplikacionit, nuk ngarkohet përsëri në mënyrë të plotë. Prandaj sugjerohet zgjedhja e versioneve të IE (internet explorer) në fund të listës së konfigurimeve si në imazhin më poshtë:





Fig.9: Konfigurimi i IE tab (version 7)

Sugjerohet aplikimi i versionit më të vjetër të 'internet explorer' pasi rrit probabilitetin drejt aksesimit të plotë të ndërfaqes Clingo.

B.2) Aksesimi i llogarisë



Për të aksesuar funksionalitetet e sistemit është e nevojshme garantimi i një llogarie në emër të institucionit spitalor përkatës. Konkretisht kërkohen kredencialet si emri i përdoruesit (username) dhe fjalëkalimi (password). Vendosija e gabuar e kredencialeve apo e të dhënave që nuk ekzistojnë në bazën e të dhënave do të pengojë përdoruesin drejt aksesit të sistemit. Prandaj është e nevojshme të ruhen kredencialet nga ana e përdoruesit apo përfaqësuesit të institucionit spitalor në sistemin Clingo. Imazhi më poshtë paraqet vendosjen e kredencialeve nga ana e përdoruesit aktual. Për probleme apo informacione referojuni seksionit të asistencës dhe suportit.

Fig.10: Aksesimi i llogarisë

Pasi keni vendosur kredencialet e sakta, do të aksesoni menunë e sistemit Clingo, siç paraqitet në imazhin më poshtë:





Fig.11: Menuja kryesore në sistemin Clingo

B.3) Menutë

1) Menuja anësore



2) Menuja Kryesore




Fig.12: Menuja kryesore + nënmenutë

❖ Inventari dhe Testet e Pranimit

Nëpërmjet menuse përkatëse do të mund të realizoni manaxhimin dhe pasqyrimin e mirëmbajtjes së pajisjes / asetit mjekësor duke shtuar, modifikuar, eliminuar, filtruar, kërkuar madje edhe për të nxjerrë pajisjen jashtë funksionit apo përdorimit.

❖ Mirëmbajtja parandaluese

Nuk aplikohet apo përdoret më në ditët e sotme. Për më shumë informacion referojuni seksionit të asistencës dhe suportit në dokumentin aktual.

❖ Ndryshimi i fjalëkalimit

Për arsye sigurie, sugjerohet gjithmonë ndryshimi i fjalëkalimit të përdoruesit. Në këtë mënyrë reduktohen mundësitë drejt aksesit të paautorizuar. Pasi realizohet ndryshimi i fjalëkalimit, sugjerohet riaksesimi i llogarisë bazuar në kredencialet e reja (fjalëkalimin e ri). Imazhi më poshtë paraqet ndryshimin e fjalëkalimit.

Shënim: Aktualisht në imazh ilustrohet ndryshimi i fjalëkalimit për llogarinë manaxhuese të institucionit spitalor në Shkodër thjesht vetëm për qëllim ilustrimi.

PASSWORD

Emri i perdoruesit: Spitali_Shkoder

Old Password: [masked]

New Password: [masked]

Confirm: [masked]

Ok

Fillimisht duhet të vendoset fjalëkalimi aktual krahas 'Old Password'. Më pas vendoset fjalëkalimi i ri krahas 'New Password' dhe është e nevojshme të verifikohet përsëri më poshtë krahas 'confirm' drejt ndryshimit me sukses të kredencialit përkatës.

Sugjerohet gjithmonë ruajtja e fjalëkalimit për të mos e harruar apo ngatërruar atë.

Për çdo problem apo informacion informohuni në seksionin e asistencës dhe suportit në dokumentin aktual.

Fig.13: Ndryshimi i fjalëkalimit

C. Inventari dhe testet e pranimit

Mirëmbajtja dhe manaxhimi i pajisjeve / aseteve mjekësore realizohet (dokumentohet) elektronikisht në menunë e inventarit dhe testeve të pranimit, e cila listohet në krye të faqes së parë. Por fillimisht sugjerohet të zgjidhet rajoni në të cilën ndodhet institucioni spitalor përkatës siç ilustruhet në imazhin më poshtë.



Fig.14: Zgjedhja e rajonit ku ndodhet spitali

Opsioni 'All' mundëson listimin e komplet institucioneve spitalore në Republikën e Shqipërisë. Opsionet e tjera si Berat, Dibër etj paraqesin vetëm institucionet spitalore në qarqet përkatëse (si Berat, Dibër etj). Pasi është selektuar opsioni i dëshiruar, klikohet butoni përzgjidhni.

Me aksesimin e menisë së inventarit dhe testeve të pranimit paraqitet ndërfaqja me funksionalitetet përkatëse si më poshtë:

Fig.15: Ndërfaqja e inventarit dhe testeve të pranimit

Nërfaqja ofron funksionalitetet si:

- **Inventari**

Nënmenuja e inventarit mundëson realizimin e kërimit të aparaturës bazuar në informacione përkatëse, paraqitjen e numrit total të aparaturave të kërkuara, inventarizimin e aparaturave të reja apo të painventarizuara. Nëse informacioni i vendosur në fushat përkatëse është i gabuar apo kërkohet boshatisja e tyre nga të dhënat e vendosura, butoni ‘fshi fushat e mbushura’ e mundëson këtë veprim. Rezultatet e kërimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen referuar butonave përkatës.

- **Testimi**

Nënmenuja e testimit mundëson dokumentimin elektronik të testimit të realizuar bazuar në aparaturën mjekësore përkatëse (e cila mund të jetë e re ose të ketë nevojë për procesin e testimit). Mund të informoheni në lidhje me numrin total të testimeve të realizuara, të krijoni një testim të ri. Gjithashtu mund të informoheni në lidhje me koston totale të testimeve përkatëse apo edhe të krijoni një test të ri pranimi në lidhje me një aparaturë të re. Mundësohet gjithashtu kërkitimi bazuar në të dhëna sipas interesit të përdoruesit apo edhe të afishohet informacioni i veçantë si rezultat i kërimeve. Butoni ‘fshi fushat e mbushura’ boshatis fushat nga informacioni i vendosur. Rezultatet e kërimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen.

- **Kërkesat**

Nënmenuja e kërkesave mundëson dokumentimin elektronik të realizimit të kërkesave për riparimin në lidhje me aparaturat / asetet mjekësore. Mund të paraqiten numrat e kërkesave të realizuara në lidhje me riparimin apo shërbimin ndaj asetit përkatës duke klikuar butonin numëro. Butoni ‘kërkesat për ndërhyrje të brendshme’ mundëson listimin e dokumentimeve elektronike të ndërhyrjes apo shërbimit ndaj aparaturës brenda departamentit përkatës në insitucionin spitalor aktual. Nëse ndërhyrja është realizuar nga ekspertë të jashtëm, dokumentimet elektronike do të mund të paraqiten nëpërmjet klikimit të butonit ‘kërkesat për ndërhyrje të jashtme’. Rekordet e paraqitura, pavarësisht tipit të ndërhyrjes, mund të modifikohen, të eliminohen, printohen madje mund të shtojmë edhe ndërhyrje të reja (e të cilat mund të realizohen edhe duke klikuar butonin ‘kërkesë e re’. Në lidhje me informacionin e kërkuar në lidhje me ndërhyrjen mund të realizohen kërkime bazuar në të dhënat e vendosura në fushat përkatëse. Për të boshatisur fushat nga vlerat, mund të klikohet butoni ‘fshi fushat e mbushura’. Rezultatet e kërkimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen.

- **Ndërhyrje të brendshme**

Nënmenuja e ndërhyrjeve të brendshme mundëson paraqitjen e dokumentimit elektronik në lidhje me ecurinë apo realizimin e ndërhyrjeve të brendshme ndaj asetit mjekësor. Mund të paraqitet numri total ndërhyrjeve aktuale apo të realizuara. Duke klikuar butonin ‘në vazhdim’, do të mund të paraqiten ndërhyrjet aktuale të cilat janë aktive (që ekzaminimi i aparaturës vijon dhe ndërhyrja ndaj saj vazhdon). Mund të kërkohet informacion në lidhje me ndërhyrjet e brendshme bazuar në të dhënat e vendosura në fushat përkatëse. Vlerat të cilat plotësojnë fushat, mund të eliminohen duke klikuar butonin ‘fshi fushat e mbushura’. Rezultatet e kërkimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen.

- **Ndërhyrje të jashtme**

Nënmenuja e ndërhyrjeve të jashtme mundëson paraqitjen e dokumentit elektronik në lidhje me realizimin apo ecurinë e ndërhyrjeve të jashtme ndaj asetit mjekësor. Ashtu si në nënmenunë e ndërhyrjeve të brendshme, edhe në nënmenunë e ndërhyrjeve të jashtme mund të paraqitet numri total i ndërhyrjeve aktuale apo të realizuara. Informacioni në lidhje me kategoritë e kostove mund të paraqitet nëpërmjet klikimit të butonit ‘nr.thirrjeve/firmë’. Butoni ‘nr.thirrjeve/repart’ mundëson paraqitjen e kostove dhe të dhënave referuese bazuar në kërkesat për shërbim në repartet përkatëse. Ecuria apo procesi në vazhdim në lidhje me shërbimin ndaj aseteve në departamentet përkatëse mund të listohen nëpërmjet klikimit të butonit ‘në vazhdim’. Mundësohet kërkimi bazuar në të dhënat e vendosura referuar fushave përkatëse si dhe boshatisja e fushave duke klikuar butonin ‘fshi fushat e mbushura’. Rezultatet e kërkimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen.

- **Magazina**

Nënmenuja e magazinës mundëson paraqitjen e dokumentit elektronik në lidhje me realizimin e një porositje të re bazuar në kërkesat e departamentit/institucionit spitalor. Mund të paraqitet numri total bazuar në kërkesa, të listohen kërkesat aktuale si dhe të mund të krijohet një kërkesë e re (funksionalitete që i referohen butonave përkatës). Rezultatet e kërimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen. Ashtu si në nënmenutë e sqaruara më sipër, edhe në nënmenunë e magazinës mundësohet boshatisja e fushave nga vlerat e vendosura nga përdoruesi nëpërmjet butonit ‘fshi fushat e mbushura’. Rezultatet e kërimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen.

- **Kontratat**

Nënmenuja e kontratës mundëson paraqitjen e dokumentit elektronik në lidhje me realizimin e kontratave bazuar në kërkesat e departamentit përkatës në institucionin shëndetësor aktual për instalim/mirëmbajtje/kontroll të aparaturave apo aseteve përbërëse të infrastrukturës klinike. Klikimi i butonit ‘numëro’ paraqet numrin konkret të rekordeve referuar kontratave. Kontratat e vlefshme (që janë aktive dhe vijojnë) apo edhe që janë përmbytur me sukses kategorizohen nëpërmjet butonave përkatës të ‘të vlefshme’ dhe ‘të mbaruara’. Madje mund të listohen gjithashtu edhe kontratat drejt përfundimit duke klikuar butonin ‘kontratat drejt përfundimit’. Butoni ‘pajisje të kontraktuara’ paraqet numrin total të pajisjeve të kontraktuara bazuar gjithmonë në kërkitime si çdo funksionalitet në butonat e tjerë. Vlerat e përlogaritura si shuma dhe mesatarja paraqiten duke iu referuar butonave ‘shuma’ dhe ‘mesatarja’ respektivisht. Gjithashtu mund të krijohet një kontratë e re duke plotësuar informacionin e nevojshëm në formularin e ri duke klikuar butonin ‘kontratë e re’. Rezultatet e kërimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen. Ashtu si në nënmenutë e sqaruara më sipër, edhe në nënmenunë e kontratës mundësohet boshatisja e fushave nga vlerat e vendosura nga përdoruesi nëpërmjet butonit ‘fshi fushat e mbushura’.

- **Pajisje të kontraktuara**

Nënmenuja e pajisjeve të kontraktuara mundëson paraqitjen e dokumentit elektronik në lidhje me kontratat e aparaturave (referuar edhe nënmenusë së mësipërme ‘kontratat’). Si në çdo nënmenu të sipërpërmendur edhe në këtë nënmenu paraqiten funksionalitetet sipas butonave. Klikimi i butonit ‘numëro’ paraqet numrin e pajisjeve të kontraktuara. Mund të kërkohet informacioni bazuar në të dhënat e vendosura në fushat e formularit të kërimit. Rezultatet e kërimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen. Ashtu si në nënmenutë e sqaruara më sipër, edhe në nënmenunë e pajisjeve të kontraktuara mundësohet boshatisja e fushave nga vlerat e vendosura nga përdoruesi nëpërmjet butonit ‘fshi fushat e mbushura’.

- **Kontrolli**

Nënmenuja e kontrollit mundëson paraqitjen e dokumentit elektronik në lidhje me kontrollin e sigurisë dhe gjendjes në punë të aseteve klinike. Për të afishuar numrin total të kontrolleve bazuar në kërkitime, klikohet butoni ‘numëro’. Realizimi i kontrollit të ri kërkon plotësimin e informacionit përkatës në formularin për rekordin e ri në databazë. Rezultatet mund të filtrohen me anë të

kërkimit, referuar të dhënave të vendosura në fushat e formularit të kërkimit. Rezultatet e kërkimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen. Ashtu si në nënmenutë e sqaruara më sipër, edhe në nënmenunë e kontrollit mundësohet boshatisja e fushave nga vlerat e vendosura nga përdoruesi nëpërmjet butonit ‘fshi fushat e mbushura’.

- **Pajisjet J.P**


Nënmenuja e pajisjeve për jashtë përdorimi mundëson paraqitjen e dokumentit elektronik referuar procedurave për nxjerrjen e aseteve klinike jashtë funksionit. Butoni ‘numëro’ paraqet numrin total të pajisjeve të cilat janë jashtë funksioni (nuk përdoren më). Butonat ‘viti në vazhdim’ dhe ‘kërko’ paraqesin të listuara informacionet në lidhje me pajisjet përkatëse të nxjerra jashtë përdorimi. Rezultatet e kërkimit mund të paraqiten, listohen, eliminohen, ndryshohen, printohen. Ashtu si në nënmenutë e sqaruara më sipër, edhe në nënmenunë e pajisjeve për jashtë përdorimi mundësohet boshatisja e fushave nga vlerat e vendosura nga përdoruesi nëpërmjet butonit ‘fshi fushat e mbushura’. Në këtë nënmenu mund të krijohet një nxjerrje e re e aparaturës së synuar për jashtë përdorimi. Fillimisht, sistemi kërkon që pajisja të figurojë si element në bazat e të dhënave. Për të shtuar një pajisje të re referojuni seksionit të inventarit në hapësirën e inventarit dhe testeve të pranimit.

Shënim:

Në lidhje me përdorimin e sistemit do të aplikohen kryesisht nënmenutë e inventarizimit si dhe të nxjerrjes jashtë përdorimit, të cilat do të paraqiten të sqaruara në këtë dokument si më poshtë.

C.1) Inventari

Ashtu siç përshkruhet shkurtimisht më sipër në lidhje me inventarizimin elektronik, nënmenuja e inventarit mundëson shtimin e rekordeve të reja inventarizuese bazuar në të dhënat e asetit klinik referuar formularit fizik të inventarizimit. Përpara se të plotësohet formulari elektronik, është e nevojshme plotësimi i formularit fizik të cilin mund ta gjeni në website-n e QKTB-së në menunë e formularëve. Në ndihmë ju vjen gjithashtu edhe udhëzimi për inventarizimin e asetit klinik. Dokumentet mund të aksesohen / shkarkohen online si dhe mund të gjenden fizikisht në QKTB. Krahas navigimit në menunë përkatëse të formularëve, alternativë konsiderohet gjithashtu aksesimi direkt në URL: <http://www.biomedical.gov.al/formulare.php>. Imazhet më poshtë paraqesin rezultatet e dobishme.



Formulare te ndryshem

Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore, është një institucion nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka si qëllim të saj mbështetjen e gjithë strukturave të sistemit shëndetësor publik për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, si dhe ofrimin e një niveli të lartë kompetence në fushën e Inxhinierisë Klinike. Në këtë kuadër, objektivi ynë kryesor është ofrimi i një shërbimi të standardeve më të mira ndërkombëtare të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë mjekësore në përputhje edhe me rekomandimet dhe direktivat e KE, për të mundësuar që jo vetëm pajisjet të jetojnë gjatë në kushte pune, por të garantojë siguri për pacientët, përdoruesit dhe të tjerët.

Emri Dokumentit	Pershkrimi	Shkarkimi
Formulari I inventarizimit	Formulari per te plotesuar per cdo aparature mjekesore e cila duhet te pajiset me numer inventari.	Shkarko
Flete Shoqeruese	Flete shoqeruese per tu plotesuar si informacion shtese i domosdoshem.	Shkarko
Udhezues	Udhezim per plotesimin e sakte te formularit.	Shkarko

Fig.16: Aksesimi i formularëve të inventarizimit (2019)

Formulari i regjistrimit të aparaturës mjekësore

1. Të dhënat bazë të aparaturës mjekësore

Nr.Inventarit # _____	Data: ____/____/____
Përshkrimi aparaturës sipas funksionit/Emri: _____	
Modeli: _____	Nr.Serisë #: _____
Prodhuesi: _____	Viti prodhimit: _____
Vendndodhja aktuale e aparaturës/Pavioni/Reparti: _____	
☐ Etiketim i ri ☐ Etiketim ekzistues	

2. Përcakto nëse po regjistron njësi qendrore apo modul

☐ Njësi qendrore
☐ Modul - Vendosi Nr. Inventarit të njësive qendrore që i përket ky modul: # _____

3. Të dhënat shtesë të aparaturës mjekësore

Gjendja aktuale e aparaturës: ☐ Funksionale, në shërbim
☐ Funksionale, jashtë shërbimi
☐ Jo funksionale

Fig.17: Faqja e parë e formularit të inventarizimit




Fig.1 Shembull i gjetjes se modelit dhe numrit te serie

- **Nr. Serisë-** Çdo aparature mjekësore ka të përcaktuar nga fabrikuesi një numër serial unik i cili i shërben firmës prodhuese për identifikimin saj. Ky numër është i domosdoshëm pasi është ndër të dhënat e para të cilën e kërkon prodhuesi në rast difekti. Numri përgjithësisht fillon me gjerat: SN.
- **Prodhuesi-** Kjo e dhënë përcakton emrin e kompanisë e cila e ka fabrikuar aparaturën e dhënë, (psh Datex Ohmeda Instrumentarium Corp)
- **Viti prodhimit-** Nëse nuk është i shënuar në aparature ose në kontratën e blerjes mundësisht të sigurohet data e hyrjes në inventarin e spitalit.
- **Vendndodhja aktuale/pavioni/reparti-** Përcakton vendndodhjen fizike të aparaturës, vendin ku pajisja kryen funksionin e saj. Dhomat e kujdesit intensiv dhe pavionet përkatëse shënohen me vete, në mënyrë të ngjashme sallat operative dhe pavionet përkatëse shënohen me vete
- **Etiketimi i ri/Etiketimi ekzistues-** Kjo pikë na shërben për të identifikuar nëse

Fig.18: Udhëzimi për inventarizimin e pajisjes mjekësore

Shënim: Në lidhje me inventarin fizik është e nevojshme dorëzimi i kopjeve përkatëse në QKTB.

Për të krijuar një hyrje të re në inventarin elektronik fillimisht klikoni në butonin ‘hyrje e re në inventar’ si në imazhin më poshtë:

Fig.19: Hyrje e re në inventar (butoni)

Pasi klikohet butoni për hyrjen e re në inventar, paraqitet formulari elektronik i cili kërkon informacionet kryesore siç paraqitet në imazhin më poshtë:

CLINGO for Asset Management 23/10/2020
Aldo_QKTB

Inventari i Aseteve

FORM

Nr.Inventarit Biomjekësor		Customer	
Nr.Inventarit te sistemit		Njësi qendrore/Modul	
Numri Serial		Klasa CE(93/42)	
Kodi i spitalit			
Kodi i departamentit			
Kodi i dhomës			
Kodi i shërbimit			
Pajisja			
Prodhuesi			
Modeli			
Përshkrimi			
Shënime			
Aksesorë			
Gjendja		Origjina	
Kodi furnitorit			
Nr. faturës		Data e faturës	
Data e Prodhimit			
Nr protokolli			
Data e dërgimit		Data e instalimit	
Data e testimit		Data e nxjerrjes JP	
Skadenca			
Cmimi (përfshirë TVSH)			
Koha e amortizimit			
Adresa e kompanisë		Përfundimi i garancisë	
Shteti i origjinës		Lloji i mirëmbajtjes	
PERIUDHA E KEQYRJES			
Data e mosgjetyes			

Ndryshuar për herë të fundit nga

KOPIO NDRYSHO FSHI HIQ I RI RUAJ DIT

CLINGO Copyright (C) 2001-2005 UMS Srl Medical Software

Fig.20: Formulari elektronik për inventarizimin e asetit klinik (fushat e detyruara)

Nëse nuk plotësohen fushat e detyruara, nuk realizohet inventarizimi elektronik në sistemin Clingo. Sugjerohet plotësimi me informacion i pjesës më të mirë të fushave të formularit duke siguruar në këtë mënyrë informacion më të plotë në lidhje me pajisjen. Kjo ndihmon në listimin e informacionit sipas kërkesave.

C.2) Pajisje/Prodhuës/Model

Informacionet kryesore në lidhje me pajisjen nën shqyrtim identifikohen duke konsideruar tipin e pajisjes, prodhuesin dhe modelin bazuar në prodhuesin përkatës për tipin e caktuar të pajisjes. Për selektimin e tipit të pajisjes mjafton të zgjidhet një alternativë nga lista 'drop down'. Kërkimi realizohet edhe më shpejt bazuar në vlerat me përqindje (%), duke ndihmuar në filtrimin e informacioneve. Në imazhin e paraqitur më poshtë listohen tipet e aparateve të anestezisë aktuale në sistem (bazuar në kërkimin me fjalë kyçe) si dhe zgjedhja e alternativës.

The screenshot displays a search interface for medical equipment. At the top, there are input fields for 'Kodi' (Code), 'Emri' (Name), 'Përshkrimi' (Description), 'Përkufizimi (IT)' (Definition (IT)), and 'Përshkrimi (IT)'. A search button labeled 'KERKO' is on the right. Below the search bar, a list of results is shown, each with a checkbox, a code, a name, a description, and a definition. The results are filtered by 'Suction unit'.

Kodi	Emri	Përshkrimi	Përkufizimi (IT)	Përshkrimi (IT)
ACH	Suction unit	A device that generates or uses negative pressure, (partial vacuum) used in the treatment of the patient, e.g. for the aspiration of fluids and/or particulate matter, or to assist in some intervention.	ASPIRATORE MEDICO CHIRURGICO	ASPIRA SANGUE, SECREZIONI, TESSUTI E LIQUIDI IN GENERALE PER MEZZO DI UNA POMPA O TRAMITE UN IMPIANTO CENTRALIZZATO.
AIB	Suction unit, thrombus	A device providing a negative pressure that is used for the removal of thrombi in the heart and surrounding arteries. It functions through the use of a controlled underpressure produced by, e.g. a venturi system fed via a pre-primed catheter which is introduced into the desired artery, and the thrombus is removed when suction is applied	ASPIRATORE PER TROMBI	COSTITUITO ESSENZIALMENTE DA UNA POMPA A VUOTO E DA OPPORTUNI CATETERI, E' USATO PER IL TRATTAMENTO DEI TROMBI IN CHIRURGIA CARDIO E INTRAVASCOLARE (TROMBECTOMIA).
LEM	Suction unit, liposuction	A device with a high-powered pump which provides an adequate negative pressure, and which is used together with a dedicated cannula for the extraction of subcutaneous fat in liposuction. This is often considered to be a cosmetic procedure	LIPOSUZIONE, SISTEMA PER	SISTEMA PER LIPOSUZIONE TRADIZIONALE (SECCA, TUMESCENTE O SUPERFICIALE), CON CANNULA RECIPROCANTE, A ULTRASUONI O LASER.

Annotations on the image:

- Kërkimi bazuar në fjalë kyçe në përqindje**: Points to the search bar.
- Emërtimi i pajisjes në anglisht**: Points to the 'Suction unit' entry.
- Përshkrimi i pajisjes në anglisht**: Points to the description of the 'Suction unit'.
- Zgjedhja e opsionit për tipin përkatës**: Points to the 'Suction unit, thrombus' entry.
- Emërtimi i pajisjes në italisht**: Points to the 'ASPIRATORE PER TROMBI' entry.
- Faqja e parë e rezultateve**: Points to the first page of results.
- Përshkrimi i pajisjes në anglisht**: Points to the description of the 'LIPOSUZIONE, SISTEMA PER' entry.

Fig.21: Filtrimi dhe zgjedhja e tipit të pajisjes

Kërkimi në lidhje me tipin e aparaturës mund të realizohet duke iu referuar kodit, emrit, përshkrimit, përkufizimit të parë / anglisht dhe italisht. Nëse rezultati i kërkuar nuk figuron në faqen e parë të listimeve, navigoni në faqet e tjera. Nëse tipi i pajisjes nuk rezulton në bazat e të dhënave të sistemit Clingo, sugjerohet të vendoset një tip pajisjeje e cila i përafrohet llojit që

kërkohet. Pasi është caktuar tipi i aparaturës, caktohen prodhuesi dhe modeli përkatës referuar inventarit fizik.

Kodi	Emri	Qyteti	Provinca	Gjendja
	%s i e%			
KERKO				
Zgjedhja e opsionit të kërkuar				
☐ ERN	ELECTRONIC CONSEL	ALES		Francia
☐ IIN	INSEL SPA	TRIESTE	TS	Italia
☐ MJP	MASSIE RESEARCH LABORATORIES INC	DUBLIN	CA	Stati Uniti
☐ SIE	SIEMENS AG	ERLANGEN		Germania
☐ SIJ	SIEGER LTD	POOLE DORSET BH177RZ		Gran Bretagna
☐ SIV	SIEM NOVA SRL	ROZZANO	MI	Italia
☐ SKW	SIE DI RESCA FRANCESCO & C SNC	BONDENO	FE	Italia
☐ SQF	SIEM SRL	SAN NICOLÒ	PC	Italia
☐ SSL	SIEM SISTEMI ELETTROMEDICALI SRL	MILANO	MI	Italia
Faqja e parë e rezultateve 1 pg: / 1				

Fig.22: Filtrimi dhe zgjedhja e prodhuesit të pajisjes

Procesi i përzgjedhjes së prodhuesit është identik me zgjedhjen e tipit të pajisjes. Fillimisht kërkohet në lidhje me kodin, emrin, qytetin, provincën, gjendjen bazuar në kërkimin me përqindje (%). Nëse elementi i kërkuar nuk listohet në faqen e parë të rezultateve, sugjerohet navigimi dhe kontrolli për rezultatin e kërkuar në faqet e rradhës. Nëse nuk gjendet prodhuesi që kërkohet (nuk figuron në bazat e të dhënave të sistemit), nuk zgjidhet asnjë opsion dhe fusha plotësohet me 3 (tre) x-e si më poshtë vijon.

Fig.23: Vendosja e prodhuesit manualisht

Pasi vendoset informacioni i prodhuesit, vijohet më tej me caktimin e modelit duke u referuar tek prodhuesi. Nëse prodhuesi është vendosur manualisht si më sipër, nuk paraqiten element në lidhje me modelin përkatës. Rezultati do jetë si më poshtë:

Kodi i aparaturës	Aparat.	Kodi i prodhuesit	Prodhuksi	Kodi i modelit	Modeli
ACH		xxx			
KERKO					
No records found.					

Fig.24: Lista boshe e modelit bazuar në prodhuesin e vendosur nga përdoruesi fundor

Kodi i aparaturës	Aparat.	Prodhuari i vendosur automatikisht	Kodi i prodhuesit	Prodhuari	Kodi i modelit	Modeli
			SIE			
Opsioni i kërkuar				Kodi i modelit përkatës		KERKO
☒ AAC	Analysér, gas, carbon dioxide		SIE	SIEMENS AG	AACSIE93	930
☒ ADG	X-ray system, diagnostic, fluoroscopic, angiographic,		SIE	SIEMENS AG	ADGSIE3V	DIGITRON 3 VAI
☒ ATA			SIE	SIEMENS AG	ATASIE6B	6 B
☒ ATA			SIE	SIEMENS AG	ATASIEAD	AMDENT
☒ ATA			SIE	SIEMENS AG	ATASIED3	D 3
☒ ATA			SIE	SIEMENS AG	ATASIESR	SIROSON
☒ AUB	Sterilizer		SIE	SIEMENS AG	AUBSIEV8	VALIDATOR PLUS 8
☒ AUB	Sterilizer		SIE	SIEMENS AG	AUBSIEVD	VALIDATOR PLUS 10
☒ AUT	Sterilizer		SIE	SIEMENS AG	AUTSIEV8	VALIDATOR PLUS 8
☒ AUT	Sterilizer		SIE	SIEMENS AG	AUTSIEVA	VALIDATOR PLUS
Faqet e navigimit		1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 pg: 1 / 100		Modeli i kërkuar		

Fig.25: Lista e modeleve bazuar në prodhuesit aktualë në sistemin Clingo

Si në rastet e caktimit të tipit të pajisjes, prodhuesit të saj edhe në përzgjedhjen e modelit sugjerohet kërkimi bazuar në përqindje (%) duke iu referuar fjalës kyçe që kërkohet. Nëse rezultati nuk paraqitet në faqen e parë, sugjerohet navigimi në faqet e radhës. Nëse rezultati i kërkuar nuk figuron përsëri, sugjerohet të përzgjidhet një model i përafërt dhe të vendoset sqarimi në fushën përkatëse të formularit të inventarizimit elektronik. Nëse elementi që kërkohet nuk figuron, mund të veprohet si më sipër duke plotësuar fushën përkatëse me 2 (dy) x-e.

Pajisja	ADG	X-ray system, diagnostic, fluoroscopic, angio
Prodhuari	SIE	SIEMENS AG
Modeli	xx	modeli

Fig.26: Plotësimi i modelit manualisht nga përdoruesi

Shënim: Sugjerohet plotësimi i shënimeve në rastin kur elementi që kërkohet (model, department etj) nuk figurojnë në bazat e të dhënave të sistemit Clingo.

C.3) Dallimi njësi qendrore / modul

Një sistem i aparaturës klinike përbëhet nga njësia qendrore dhe modulet. Si shembull mund të përmendim sistemin grafi skopi ku mund të listojmë komponente si paneli i kontrollit, shtrati, koka e tubit të rrezeve X etj. Seicila prej komponentëve përbërës duhet të inventarizohet dhe të identifikohet nëpërmjet etiketës unike të inventarizimit (të cilat mund të tërhiqen në sektorin e inxhinierisë klinike në QKTB nëpërmjet kërkesës përkatëse nga institucioni shëndetësor nëpërmjet shkresës ose adresës elektronike). Më poshtë ilustron si shembull një sistem kompjuterik duke dalluar komponentët (modulet) dhe njësinë qendrore.




Fig.27: Monitori (modul)



Fig.28: Njësia qendrore

INVENTARI MINISTRIA E SHËNDETËSISË 67891
--

INVENTARI MINISTRIA E SHËNDETËSISË 12345
--

Shembulli i paraqitur ilustron komponentët kryesorë në një sistem kompjuterik. Aktualisht njësia qendrore (truri) është paraqitur në fig.28. Njësia përmban kapacitetet kryesore për të realizuar detyrën për të cilën aplikohet. Njësia qendrore paraqet informacionin e saj nëpërmjet një monitori (të paraqitur në fig.27). Nëse monitori (ekrani) nuk funksionon, mund të ndërrohet dhe të përshtatet me lehtësi me njësinë qendrore si një pajisje periferike efikase. Kjo njësi do të konsiderohet si modul dhe do të inventarizohet individualisht (jo së bashku me njësinë qendrore si një sistem i vetëm). Nëse njësia qendrore do të dëmtohej, humbjet dhe dëmtimet në lidhje me aplikimin e saj do të paraqisnin një ndikim më të madh ndaj përdoruesit fundor. Ky fakt paraqet rolin dhe rëndësinë e njësive qendrore dhe si pasojë është e nevojshme inventarizimi individual i këtij asemi. Sistemi paraqet 2 (dy) module kryesore të cilat inventarizohen seicila më vete si në dokumentimin fizik (formularët) edhe në atë elektronik (nëpërmjet sistemit Clingo). Nëse sistemi kompjuterik nuk përbëhet nga komponentë por rezulton i assembluar në një njësi të vetme (rasti i laptopit), njësia do të konsiderohet si një njësi qendrore dhe do të identifikohet nga një numër inventari.



INVENTARI MINISTRIA E SHËNDETËSISË 11121
--

Imazhet ilustrohen së bashku me numrat e inventarit

Fig.29: Njësia laptop

Inventarizimi i njësisë qendrore do të paraqitet siç ilustruhet më poshtë në sistemin Clingo.

Inventari i Aseteve

Nr.Inventarit Biomjekësor	12345	Customer	QSUT
Nr.Inventarit te sistemit	12345	Njësi qendrore/Modul	Njësi qendrore
Numri Serial	abcdefg	Klasa CE(93/42)	
Kodi i spitalit	125D SHERBIMI ONKOLOGJIK		
Kodi i departamentit	01/125D Spitali Onkologjik		
Kodi i dhomës			
Kodi i shërbimit			

Fig.30: Inventarizimi i njësisë qendrore në sistemin Clingo

Me zgjedhjen e opsionit të njësisë qendrore, numri i inventarit të sistemit plotësohet automatikisht nga sistemi duke marrë të njëjtën vlerë me numrin e inventarit biomjekësor (si më sipër). Në rastin e inventarizimit të njësisë modul zgjidhet opsioni ‘modul’ dhe vendoset numri i inventarit të njësisë qendrore të cilës i referohet pajisja përkatëse. Numri i inventarit biomjekësor identifikon numrin specifik të inventarit në lidhje me pajisjen përkatëse. Imazhi më poshtë paraqet inventarizimin e njësisë modul bazuar në njësinë qendrore në sistemin Clingo.

Nr.Inventarit Biomjekësor	67891	Customer	QSUT
Nr.Inventarit te sistemit	12345	Njësi qendrore/Modul	Modul
Numri Serial	abcdefg	Klasa CE(93/42)	
Kodi i spitalit	125D SHERBIMI ONKOLOGJIK		
Kodi i departamentit	01/125D Spitali Onkologjik		
Kodi i dhomës			
Kodi i shërbimit			

Fig.31: Inventarizimi i njësisë modul bazuar në njësinë qendrore në sistemin Clingo

Shënim: Nuk është e nevojshme plotësimi i kodit të dhomës apo kodit të shërbimit në lidhje me inventarizimin elektronik në sistemin Clingo.

Për të zgjedhur rajonin, qendrën spitalore apo departamentin, tipin (njësi qendrore / modul) veprohet si në rastet e funksionaliteteve të tjera të paraqitura më sipër në këtë dokument.

C.4) Të dhëna të tjera

The screenshot shows a web-based form for recording electronic equipment inventory. The form is organized into several sections with labels on the left and input fields on the right. The labels are: Përshkrimi, Shënime, Aksesore, Gjendja, Kodi furnitorit, Nr. faturës, Data e Prodhimit, Nr protokolli, Data e dërgimit, Data e testimit, Skadenca, Cmimi (përfshirë TVSH), Koha e amortizimit, Adresa e kompanisë, Shteti i origjines, PERIUDHA E KEQYRJES, and Data e mosgjetjes. The input fields include text boxes, dropdown menus, and checkboxes. Some fields are pre-filled with values like 'AB', '12345', '20/08/2019', '12', '10/10/2020', '200000', 'addr', 'NË', and 'Dhurim'. The form also includes a 'Ndryshua' (Changed) button at the bottom right.

Fig.32: Plotësimi i fushave të tjera në lidhje me inventarizimin elektronik të pajisjes në sistemin Clingo

Informacioni i paraqitur nëpërmjet ilustrimit të mësipërm nuk është i detyruar. Sugjerohet plotësimi i formularit të inventarizimit elektronik bazuar në të dhëna të verifikuara dhe informacioneve të sakta. Plotësimi i një numri të konsiderueshëm të fushave në formular favorizon inventarizimin e plotë dhe preciz nga përdoruesi fundor apo administratori përkatës. Në rastin e gabimeve apo ndryshimeve sipas interesit dhe kërkesave, të dhënat mund të modifikohen, eliminohen bazuar në butonat përkatës.

D. Nxjerrja e pajisjes jashtë funksioni

Sistemi Clingo mundëson gjithashtu dokumentimin elektronik në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve të synuara, bazuar në nënmenunë e 'pajisjet j.p' në seksionin e 'inventarit dhe testet e pranimit' për pajisjet mjekësore. Fillimisht sugjerohet inventarizimi fizik dhe elektronik i pajisjeve mjekësore të cilat synohen të dalin jashtë funksionit. Nëse pajisja nuk rezulton e inventarizuar në sistemin Clingo, nuk mund të vijohet më tej me nxjerrjen e saj jashtë përdorimit. Procesi i inventarizimit elektronik paraqitet më sipër në këtë dokument. Më poshtë ilustrohet funksionaliteti i nxjerrjes së një pajisjeje jashtë përdorimit.

Pajisjet J.P

Viti	2020	Numri i nxjerrjes JP	??
Data e nxjerrjes JP		Sektori kërkues për nxjerrje JP	Teknologji Biomjekësore
Gjendja	Në gjendje pune	Data e kontrollit	
Shkaku 1		Nr.i inventarit	
Shkaku 2			
shkaku 3			
Shkaku 4			
Tekniku			
☐ Pajisje e rrezikshme për përdoruesin/pacientin ☐ Riparim/rishikim i pavlefshëm ☐ Pajisje e vjetër/me të dhëna të dyshimta/e papërshtatshme për përdorim ☐ E papërdorur ☐ Lënë për përdorim nga reparti/shërbimi			
Nr.protokollit të dërgimit		më	

Fig.33: Fushat e detyruara në formularin e nxjerrjes së pajisjes jashtë përdorimi

Si në inventarizimin e pajisjes mjekësore, edhe në këtë rast sugjerohet plotësimi i formularit elektronik me sa më shumë informacion. Zgjedhja e vlerave apo vendosja e tyre realizohet njësoj si në formularët elektronik të paraqitur më parë në këtë dokument. Imazhi më poshtë ilustron plotësimin e formularit elektronik në lidhje me nxjerrjen e pajisjes së synuar jashtë përdorimi nga përdoruesi fundor.

Pajisjet J.P

Viti	2020	Numri i nxjerrjes JP	??
Data e nxjerrjes JP	20/10/2020	Data e kontrollit	10/10/2020
Sektori kërkues për nxjerrje JP	Nxjerre JP		
Gjendja	Nxjerre JP	Nr.i inventarit	22232
Shkaku 1	Shkaku i parë pse pajisja po nxirret jashtë funksion		
Shkaku 2	Shkaku nr.2 (jo i detyrueshëm)		
Shkaku 3	Shkaku nr.3 (jo i detyrueshëm)		
Shkaku 4	Shkaku nr.4 (jo i detyrueshëm)		
Tekniku	032	Ishmaku Ilir	
	☒ Pajisje e rrezikshme për përdoruesin/pacientin ☒ Riparim/rishikim i pavlefshëm ☒ Pajisje e vjetër/me të dhëna të dyshimta/e papërshtatshme për përdorim ☐ E papërdorur ☐ Lënë për përdorim nga reparti/shërbimi		
Nr.protokollit të dërgimit	02	më 20/10/2020	

Fig.34: Plotësimi i formularit elektronik bazuar në nxjerrjen jashtë funksionit të pajisjes në Clingo

Sugjerohet të vendosen të dhëna të paktën bazuar në një shkak në lidhje me arsyen pse pajisja po del jashtë funksioni. Ashtu si në formularët elektronik të paraqitur si më sipër në këtë dokument, edhe në këtë formular, përdoruesi mund të eliminojë informacionin, modifikojë atë sipas kërkesave apo interesit duke u referuar në butonat përkatës.

Shënim: Nëse pajisja është nxjerrë më parë jashtë përdorimi, nuk mund të nxirret përsëri jashtë funksioni. Nëse pajisja është nxjerrë jashtë përdorimi, informacioni i afishuar në lidhje me të paraqet gjithashtu opsionin ‘Si’ (po në italisht) dhe ‘No’ (jo në italisht) në rastin e kundërt kur pajisja nuk është nxjerrë akoma jashtë përdorimi.

Si në formularët e paraqitur më parë në këtë dokument sugjerohet verifikimi i informacionit drejt realizimit me sukses të një veprimtarie të saktë për nxjerrjen e aparaturës jashtë funksioni.

E. Politikat dhe privatësia



Sistemi Clingo është një aplikacion i programuar në vitin 2005. Bazuar në rëndësinë dhe rolin e sistemit ashtu siç paraqitet në këtë dokument, është e nevojshme respektimi rigoroz i politikave dhe instruksioneve në favor të përdorueshmërisë, sigurisë dhe aplikimit.

1. Akses i palejuar

Infrastruktura e sistemit monitoron veprimtaritë e përdoruesave fundorë duke evidentuar probleme në lidhje me aplikimin dhe sigurinë e llogarisë institucionale bazuar në aksesin e palejuar. Evidentimi i një veprimtarie të tillë do të nxisë marrjen e masave kundrejt autorit përkatës.

2. Manipulimi i të dhënave

Ndalohej rreptësisht manipulimi i të dhënave bazuar në kërkesat dhe interesat personale apo të paautorizuara. Vetëm personeli i autorizuar mund të aksesojë sistemin Clingo. Evidentimi i një veprimtarie të tillë do të nxisë marrjen e masave kundrejt autorit përkatës.

3. Publikimi i informacionit

Ndalohej rreptësisht shpërndarja / publikimi i të dhënave në mënyrë të paautorizuar sipas interesave personale në lidhje me atë çfarë ofron sistemi. Evidentimi i një veprimtarie të tillë do të nxisë marrjen e masave kundrejt autorit përkatës.

4. Veprimtaria ofensive

Ndalohej rreptësisht aplikimi i metodave ofensive bazuar në sistemin aktual qoftë edhe me synimin e evidentimit të problemeve apo dobësive që mund të paraqiten. Evidentimi i një veprimtarie të tillë do të nxisë marrjen e masave kundrejt autorit përkatës.

Sistemi Clingo mirëmbahet dhe manaxhohet nga 'Departamenti i Inxhinierisë Klinike' në QKTB. Për çdo problem apo informacion mund t'i referoheni seksionit të asistencës dhe suportit të paraqitur në këtë dokument.

Shënim: Ndalohej rreptësisht aksesimi / dublikimi i këtij dokumenti në mënyrë jo të autorizuar. Evidentimi i një veprimtarie të tillë do të nxisë marrjen e masave.

F. Asistenca dhe suport

Spektori i inxhinierisë klinike garanton asistencë dhe suport në lidhje me inventarizimin e aseteve mjekësore si dhe trajnime në lidhje me aplikimin e sistemin Clingo. Për të krijuar një llogari të re manaxhimi, apo ndryshuar kredencialet e humbura, si dhe për çdo problem apo informacion mund të kontaktoni me QKTB.



qkib@shendetesia.gov.al



Rruga e Dibrës, nr.12 (pranë QSUT) Tiranë / Shqipëri (ALB)

F.1 Error-et


Sistemi i manaxhimeve të aseteve Clingo, bazuar edhe në infrastrukturën e aksesimit nga ana e përdoruesit fundor, paraqet probleme dhe error-e. Imazhi më poshtë paraqet një mesazh error-i në lidhje me listën e alternativave / opsioneve që kërkohen.

```
Error during load 'Config\ListButton.xml'
The system cannot find the path specified.
```

Fig.35: Mesazh error-i

Për të shmangur problemet që mund të shfaqen në lidhje me aksesimin / përdorimin e sistemit, sugjerohet riaksesimi i sistemit aktual. Riaksesoni shfletuesin (Google Chrome) dhe aksesoni përsëri sistemin Clingo siç paraqitet në këtë dokument më sipër.

F.2 Pyetje / Përgjigje



Institucioni shëndetësor



Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore

-
- Kam humbur fjalëkalimin dhe nuk mund të aksesoj dot llogarinë në Clingo. Si mund të veproj për të riaksesuar atë?
 - Fillimisht dërgoni një kërkesë me shkrim (postë) ose nëpërmjet adresës elektronike ku paraqisni problemin tuaj. Prezantoni institucionin shëndetësor që ju përfaqësoni dhe mundësisht jepni informacion në lidhje me kredencialet aktuale. Stafi ynë do të përgjigjet në lidhje me fjalëkalimin tuaj duke e rikthyer atë në gjendje fillestare.
-
- Kam nevojë për trajnim në lidhje me aplikimin e sistemit Clingo. Ku mund të adresohem?
 - Fillimisht dërgoni një kërkesë me shkrim (postë) ose nëpërmjet adresës elektronike të QKTB ku të paraqisni kërkesën tuaj. Prezantoni institucionin shëndetësor që ju përfaqësoni dhe sektori i inxhinierisë klinike do të përgjigjet në lidhje me trajnimin që kërkon. Trajtimi mund të realizohet online (remote), nëpërmjet këtij manuali apo edhe në ambientet e departamentit të inxhinierisë klinike.
-
- Nuk mund të aksesoj sistemin Clingo. Nuk kam kredenciale dhe më duhet një llogari e re. Ku mund ta krijoj një të tillë?
 - Ju nuk mund të krijoni një llogari të re. Për këtë duhet të drejtoheni me kërkesë nëpërmjet shkresës (postë) apo adresës elektronike të paraqitur në seksionin e asistencës dhe suportit në këtë dokument. Prezantoni institucionin që ju përfaqësoni dhe paraqisni kërkesën tuaj në lidhje me krijimin e një llogarie të re manaxhimi. QKTB do ju kontaktojë llogarinë ekzistuese të institucionit tuaj (nëse ajo është aktive) ose do të krijojë llogarinë e re bazuar në kërkesën tuaj.

G. Shtesë / Shënime